




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e dytë (II) e Kuvendit të Komunës Gjilani, mbajtur më 2.3.2012 me këtë me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2011,
3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Seancës
- Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së dytë morën pjesë :
Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive
Kryetari i Komunës
Përfaqësuesit e OSB-së
Njësia për Mbrojtjen e te Drejtave të Njeriut
Forumi Demokratik ‘Anamorava’
Mediet

Seancën e dytë të KK-së për vitin 2012 e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

Në fillim të seancës u kërkuar që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në seancë.

Nga sekretaria u konstatua se në punimet e kësaj seanca ishin të pranishëm 38 anëtarë të Kuvendit kurse munguan 3: Xhyzide Ismaili, Arzie Nuhiu, Ejup Haziri,

Izmi Zeka- pasi që ka kuorum për të vazhduar me punë, z. Zeka theksoi se në rend të punës është shqyrtimi i Raportit të kryetarit të Komunës për vitin 2011, por para raportit do të propozoj që të jetë si pikë e parë;

betimi solemn i një anëtarit të ri KK-së, por janë edhe disa materiale të cilat i keni marrë pak me vonesë, por për shkak të specifikave dhe çështjeve urgjente, duhet të futen në rend të punës e të cilat janë:

3. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2010, në vitin fiskal 2012
4. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2011, në vitin fiskal 2012-
5. Propozim-vendimi për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizmit të të hyrave të planifikuara nga viti 2011 dhe bartja e tyre në vitin fiskal 2012
6. Propozim- vendimi për lejimin e transferimit të mjeteve financiare

Jakup Bajrami- pasi që jemi duke debatuar për rendin e punës, unë po ia përkujtoj Kuvendit që më 8 mars bëhet një vit kur ish kryetari i Komunës, i ndjeri Xhemajl Hyseni e mbush një vit që ndërroi jetë, prandaj unë propozoj që ta mbajmë një Akademi përkujtimore për ta përkujtuar veprën dhe punën e ish kryetarit të Komunës z. Xhemajl Hyseni.

Elisah Ymeri- unë po e përsëris një kërkesë të mëparshme e ajo është që neve materialet për seancë të na sillen si kopje fizike për të pasur mundësi për ta analizuar materialin më mirë. Është e pamundur mbi 120 faqe të lexohen në kompjuterë, prandaj këto materiale duhet të na dërgohen në kopje fizike.

Sokol Haziri- unë nuk e kam të qartë se cili është rendi i ditës për sot, sepse pos atyre që i kërkoi kryesuesi për të hyrë në rend të punës, sipas të gjitha gjasave ka edhe të tjera.

Mirëpo në ndërkohë ka arrit edhe një rregullore për taksat dhe gjobat, për të cilën ju nuk thatë asgjë, prandaj kam pyetje a është edhe kjo pikë e rendit të ditës?

Mandej ne parimisht do të pajtohemi me rendin e ditës, por kërkojmë një arsytim prej drejtorisë përkatës, pse për çështje të financave po ndodh kështu? Gjithmonë për çështje të financave paraqitet diçka urgjente. Nëse është diçka urgjente prej Qeverisë është tjetër çështje, por nëse kjo ndodh nga ana e jonë, ne nuk jemi pajtuar që ky rend i ditës të jetë kështu! Mirëpo nëse është tepër urgjente, ne nuk do ta pengojmë këtë proces!

Abdyl Aliu- nuk ka të bëjë me rendin e punës, por kam vetëm një pyetje lidhur me rregulloren për të cilën e kemi marrë një kopje, por në të cilën nuk janë inkorporuar ato ndryshimet të cilat i kemi aprovuar në Kuvend? Ka pika të cilat nuk janë në rregullore, ato të cilat i kemi propozuar dhe janë aprovuar!

Izmi Zeka- lidhur me Rregulloren, e dini se vete e keni autorizuar Komitetin për Politikë dhe Financa për t' i bërë ndryshimet. Ky komitet i ka hyrë punës për këtë rregullore që nga fillimi deri në mbarim dhe këto ndryshime, komiteti i ka bërë në pajtim me propozimet e juaja. Asgjë nuk ka diçka që bie në kundërshtim me propozimet e juaja.

Abdyl Aliu- ashtu është dhe unë pajtohem se e kemi obliguar Komitetin për Politikë dhe Financa për t' i inkorporuar ato propozimet tona, por ato nuk janë tash në rregullore.

Izmi Zeka- nëse ka gjëra të tilla mund t' i sillni me shkrim për të parë se çka nuk është përfshirë?

Lidhur me Akademinë përkujtimore me rastin e një vjetorit të vdekjes së ish kryetarit të Komunës Xhemajl Hyseni mund ta mbajmë më datën 8 mars.

Kuvendi aprovoi kërkesën që të mbahet një Akademi përkujtimore për ish kryetarin e Komunës në të cilën do të marrin pjesë anëtarët e Kuvendit dhe familjarët e ish kryetarit Xhemajl Hyseni.

Lidhur me atë kërkesën e kopjeve fizike, ne iu kemi sjell llap-topët për ta lehtësuar procedurën e kësaj dukurie, në mënyrë që më lehtë t' i lexoni dhe t' i keni materialet në llap-topët e juaja.

Elisah Ymeri- është e kuptueshme që ndonjë shkresë ose dokument tjetër të na dërgohet në adresë elektronike, por një raport siç është prej 140 faqeve, kush ka mundësi për ta printuar? Këto materialet me shumicë të na dërgohen si kopje fizike, kurse ndonjë shkresë ose dokument më i shkurtër mundet edhe me anë të llap-topëve.

Sabedin Kadriu- unë e kam një vërejtje se nëse thirren mbledhjet solemne të KK-së, iu lus që ajo të jetë mbledhje e Kuvendit dhe këshilltarët të ulen nëpër vende të veta, kurse drejtorët nuk kanë nevojë të vijnë në mbledhje solemne, kurse mysafirët që vijnë mund të ulen në ulëse të drejtorëve, sepse drejtorët nuk e kanë obligim të vijnë.

Në këtë mënyrë si po veprohet ajo nuk është mbledhje solemne e Kuvendit, por mbledhje e qytetarëve të Gjilanit.

Izmi Zeka- nuk duhet të harrojmë se drejtorët janë pjesë e KK-së, janë pjesë e ekzekutivit dhe janë pjesë e tërë kësaj pune! Si i kanë vendet këshilltarët, ashtu i kanë edhe drejtorët.

Në mbledhje solemne dhe ato komemorativet ne duhet t' i respektojmë të tjerët !

Sabedin Kadriu- unë nuk desha ta ofendoj asnjë drejtorë, por e thash se në mbledhje solemne drejtorët nuk e kanë obligative për të prezantuar! Nëse ne rrimë në këmbë dhe nuk ulemi në vendet tona, atëherë nuk është mbledhje solemne dhe atëherë duhet lënë tjetër emër.

Qemajl Mustafa- nuk funksionon Kuvendi pa drejtorë? A keni parë diku se funksionon një Kuvend i shtetit pa qeveri? A keni parë diku që funksionon një KK, pa praninë e drejtorëve?

Elisah Ymeri –mua më vjen keq që devijoj kahja e debatit, por po iu them një sugjerim nga praktikat e kuvendeve të komunave të tjera sepse ato mbledhjet e tilla solemne dhe komemorativet i mbajnë nëpër salla të tjera. Ne kemi sallën dhe në atë sallë i kënaqim të gjithë dhe ulet secili ku të dojë.

Izmi Zeka- faleminderit për këtë propozim, ne mbledhjen komemorativet do ta mbajmë në sallën e Teatrit?

Sadudin Berisha- në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së propozoj që t' i vazhdohet edhe për një vit ndihma familjes së kryetarit të ndjerë Xhemajl Hyseni dhe besoj se do të jenë të pajtimit dhe grupet e tjera, sepse muaji mars është i fundit, kur kemi marrë vendim për ta ndihmuar familjen e tij. Kjo ndihmë ka qenë njëvjeçare, andaj duhet pasur mirëkuptim për t' ia vazhduar këtë ndihmë.

Izmi Zeka- propozimi për Akademi për përkujtimore, mendoj se duhet të mbahet, prandaj kush është për atë që kjo Akademi për ish kryetarin e Komunës, Xhemajl Hyseni të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal më 8 mars ora 11

Aprovohet ky propozim që Akademia përkujtimore për ish kryetarin e Komunës, Xhemajl Hyseni të mbahet më 8 mars ora 11 në sallën e KK-së.

Arben Maliqi- i nderuari kryetari i Komunës, këshilltarë dhe drejtorë dhe të gjithë të pranishëm. Mua po më habit fakti dhe po e them pa të keqe dhe për pasur qëllim për ta lënduar dike, por gati të gjithë ata që e morën fjalën nuk i përshëndetën të pranishmit, kryesuesin, kryetarin e Komunës dhe këtu po më përngjan sikur këtu të ishte treg.

Është mirë këtu ta kemi një kulturë të komunikimit, kur ta marrim fjalën duhet t' i përshëndesim të gjithë të pranishmit.

Qasja e komunikimit duhet të jetë pak më ndryshe, kurse kryesuesin e lus që fjalën askujt mos t'ia japin nga 5-6 herë.

Ne sot e kemi një raport të gjerë të kryetarit të Komunës, prandaj ta merr fjalën kryetari i Komunës dhe mos të kalojmë në gjëra anësore. Ju lus të kalojmë në temë dhe mos të humbim kohë pa nevojë!

Izmi Zeka- unë propozoj që të aprovohet rendi i punës me këto pika të cilat u propozuan edhe gjatë debatit? Ju lutem të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi i punës me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime

Procesverbali-

Leonorë Bunjaku- një gabim teknik, nuk duhet të jetë trasim i drunjve, por i rrugëve

Aprovohet procesverbali me këtë vërejtje

2. Betimi solemn i anëtarit të rinj të KK-së

Betimin solemn e jep Sami Hoxha si anëtar i rinj i KK-së nga radhët e PDK-së, sepse një anëtarë i PDK-së (Riad Rashiti), është emëruar drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

3. Raporti i punës së kryetarit të Komunës për vitin 2011

Izmi Zeka- në rend të punës është raporti i kryetarit për vitin 2011, në të cilin raport është një elaborim i tërë punës që është bërë gjatë një viti. Kuvendi duhet të njoftohet për të gjitha këto gjëra me të gjitha të arriturat në Komunë, por edhe me pengesat dhe sfidat që i ka pasur kjo qeverisje. Fjalën do ta ketë kryetari, kurse pas fjalës së kryetarit do të hapim debatin.

Qemajl Mustafa- e falënderoj kryesuesin, përshëndetje për këshilltarët, drejtorët dhe të gjithë të tjerët të pranishëm të cilët po monitorojnë dhe po e ndihmojnë Kuvendin.

E kam kënaqësinë t'iu them se edhe viti 2011, sikurse edhe dy vitet përpara me pak ngecje në aspekte zhvillimore të infrastrukturës ka qenë vit i suksesshëm dhe ky sukses i atribuohet të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit, të gjitha grupeve politike në Kuvend, shoqërisë tjetër civile, të gjithëve që krijuam klimë të volitshme për të punuar normalisht.

Në vijim të fjalës së tij kryetari filloi gjerësisht për ta elaboruar raportin e tij të cilin raport të gjithë këshilltarët e kanë pasur së bashku me materialin e seancës, kurse pas fjalës së kryetarit u hap debati për anëtarët e Kuvendit.

Arben Mehmeti- në emër të grupit parlamentar të LDK-së përshëndesim punën njëvjeçare të qeverisjes lokale të Gjilanit. Raporti i cili na është ofruar nga kryetari i Komunës, ka gjëra pozitive, por në përgjithësi flitet për veprimet pozitive të Administratës Komunale për pa u theksuar në ndonjë mënyrë edhe problemet dhe sfidat të cilat janë paraqitur gjatë vitit fiskal 2011. Ka qenë desh edhe format jo të mira dhe vështirësitë në të cilat ka has Administrata të specifikohen më hollësisht dhe ato të jenë në formë të rekomandimeve për vitin në të cilin gjendemi.

Ne si grup politik jemi të kënaqur me komunikim që e kemi pasur me Zyrën e kryetarit të Komunës i cili komunikim ka qenë më i mirë se me drejtoritë përkatëse, sepse raporti me drejtorit përkatëse shpesh ka pasur jo seriozitet, sepse drejtorët shpesh e kanë konsideruar veten se janë zyrtarë mbi Kuvendin. Këtë po e dëshmoj me atë se ne kemi pasur kërkesa të ndryshme me shkrim dhe ato na janë kthyer me një arsyetim se nuk janë drejtuar në adresa adekuate e gjëra të tjera.

Me disa nga drejtoritë dhe zyrat kemi komunikuar edhe me shkrim mjaft mirë dhe disa nga drejtoritë i kanë marrë seriozisht disa rekomandime tona.

Raporti i kryetarit të Komunës, është një raport i cili më tepër i drejtohet qytetarëve dhe nuk është raport i specifikuar dhe serioz dhe nuk i ka disa elemente për ta konsideruar raport të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Unë konsideroj se në të kaluarën raporti i kryetarit të Komunës ka qenë më i mirë se ky i cili po na prezantohet sot dhe në raport me neve është i papërshtatshëm, sepse edhe ne jemi pjesë e këtij Kuvendi dhe jemi pjesë e aktiviteteve të përditshme të punës së ekzekutivit dhe Kuvendit.

Po ashtu në raport mungojnë shumë veprime konkrete të drejtorive përkatëse e të cilat kanë qenë edhe në kundërshtim me ligjin dhe të cilat kanë mbetur për pa u specifikuar, por ne në ndërkohë do t' i bëjmë publike edhe këto veprime dhe janë organet të cilat do të merren edhe me këto gjëra.

Unë kam kërkuar disa herë nga Zyra e Auditimit për ta marrë raportin për vitin 2011, por na është thënë se sipas nenit 12.1.6, Auditori i Brendshëm, raportin të menaxhmenti i lartë i Komunës! Mirëpo këtë përgjigje unë ende nuk e kam të qartë se Kuvendi i Komunës çka llogaritet? A nuk llogaritet si organ i lartë i kësaj Komune dhe a nuk llogaritet si menaxhment i lartë i kësaj Komune? Në çfarë cilësi është Kuvendi, kur unë e di dhe të gjithë të tjerët se Kuvendi është organi më i lartë i Komunës së Gjilanit.

Nëse ligji e ka specifikuar që nëse menaxhmenti i lartë i Komunës është kryetari edhe drejtoritë, atëherë është tjetër çështje dhe ndoshta unë e kam gabim. Mirëpo derisa nuk e kam këtë informatë, unë mendoj pjesë e menaxhmentit të lartë është Kuvendi e pastaj kryetari dhe të tjerët. Po ashtu edhe me Zyrën e Prokurimit kemi pasur komunikim mjaft të mirë, por na kanë munguar informatat të cilat i kemi kërkuar ne, por pikërisht edhe pse komunikimet jo kualitative në kërkesat tona, sepse ne kemi pasur një kërkesë për Planin e prokurimit për vitin 2012 dhe kemi marrë informatën që ai plan është konfidencial dhe nuk mund të jetë për Kuvendin dhe grupet politike! Kjo për mua është e pakuptimtë dhe është jashtë çdo logjike!

Ne në këtë rast jemi konsideruar si publik, por edhe si operator ekonomik!

Gjithashtu në Zyrën e Prokurimit unë e kam kërkuar dhe një listë të komisioneve të ndryshme për të cilat disa i kam marrë si është komisioni i vlerësimit. Ne e falënderojmë shefen e prokurimit, sepse shpejtë iu ka përgjigj kërkesave tona dhe kjo është formë e mirë e komunikimit, por në atë komision të vlerësimit kemi hasur në raste, kur një person është afër 40 herë nëpër komisione të vlerësimit të tenderëve. Kjo për mua është shumë e pa kuptimtë, por këtë duhet vlerësuar kujdesshëm për të parë se cila është arsyeja që vazhdimisht të njëjtit njerëz të jenë nëpër komisione të tilla. Komuna është e fokusuar në 10 zyrtarë dhe vetëm ata e bëjnë vlerësimin e ofertave dhe vlerësimin se kush duhet të merr punë në këtë Komunë.

Nga kjo shihet se është afër 40 herë i njëjti person, kjo është me dokument e vërtetuar.

Na kanë munguar edhe mbikëqyrjet në projektet e caktuara edhe pse është një kompanie cila e ka fituar tenderin për t' i mbikëqyrë projektet e caktuara, por nga informatat që i kemi ne, Administrata Komunale, vazhdon përsëri të ketë komisione të mbikëqyrjes teknike në projekte të caktuara edhe pas asaj date që e ka fituar tenderin kompania përkatëse. Edhe me këtë rast ka elemente negative dhe duhet shikuar hollësisht si është problemi?

Lidhur me Inspektoratin kemi biseduar herën e kaluar, sidomos për dënimet për ata që nuk i respektojnë rregullat, por Inspektorati e ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e kësaj fushe, kurse ne vazhdimisht po i sanksionojmë ata që më së paku kanë qenë fajtor në raport me këta që kanë pasur obligim ligjor dhe kompensohen për punën të cilën duhet ta bëjnë.

Edhe te Inspektorati mungojnë edhe disa informata shitesë për të cilat disa herë kemi bërë debate në Kuvend, por ato sot nuk janë pjesë e raportit. Ka shumë zona të caktuara që me plan urbanistik është i ndaluar ndërtimi, por ato vazhdojnë çdo ditë dhe nuk kanë të ndalur, sidomos ndërtimet e nivelit të mesëm.

Te shërbimet publike jemi dëshmitarë të dështimit të sinjalizimit horizontal dhe të shpenzimit të madh të mjeteve në këtë aspekt, por cilësia e punëve është shumë e dobët, sepse këto ditë së bashku me borën e cila shkrihej edhe ngjyra e shenjave fshihej në rrugë.

Këtu kemi të bëjmë me investime të cilat nuk janë as kualitative dhe nuk janë as në interes të Administratës Komunale me vet faktin që epen para të mëdha, kurse efekti i tyre është shumë i dobët! U tha se bujqësia është në nivel dhe e mirë, por unë po them se është dhe ka investime, por në shërbime të grupeve të caktuara

politike dhe të gjitha projektet të cilat janë duke u zbatuar aktualisht mungon një komision i përbashkët i cili ka besimin e këtij Kuvendi dhe të subjekteve kryesore. Kjo duhet të bëhet për të mos pasur dyshime se ka keqpërdorime.

Është projekti i drunjve dekorativ i cili është për t' u diskutuar, sepse edhe ne si Kuvend nuk e kemi të qartë se cili është realisht ai projekt, sepse ne në këtë Kuvend e kemi aprovuar një vendim deri në 10 mijë euro dhe e kemi të përcaktuar edhe zonën se ku duhet të vendosen.

Kjo më kujtohet mirë se këta drunj ka qenë desh të mbillen deri te Posta e Madhe, por deri më sot nuk ka aty asnjë dru dekorativ. Gjithashtu edhe çështja e tenderit nuk ka qenë e planifikuar në vitin 2011 te Prokurimi, kurse janë ekzekutuar parcialisht, kurse në detale nuk i dimë fazat se si do të realizohet ky projekt?

Te kultura dhe te "Flaka e Janarit" është një menaxhim jo i mirë i buxhetit të asaj drejtorie, sepse kemi një kontroll jo të duhur të shpenzimit të mjeteve dhe aty ka pasur vend që të identifikohen problemet e caktuara e të cilat identifikime mund t' i bëjë drejtori dhe të jetë vetëm një aspekt teknik për mbulim të atyre faturave dhe shpenzimeve të caktuara.

Për "Flakën e Janarit" e kemi marrë një raport i cili nuk është i kompletuar dhe është shumë i mangët, sepse mungojnë shumë informata për të qenë më të informuar ashtu si duhet, buxheti është i madh që është shpenzuar, por mungojnë specifikat e caktuara.

Për Drejtorinë e Financave po e them vetëm një problem se kjo drejtori nuk i respekton vendimet e këtij në Kuvendi për çështje të komisioneve të ndryshme të cilat janë nxjerr nga ky Kuvend.

Tek borxhet as ne si Kuvend nuk i kemi të dhënat se sa ka Komuna borxh realisht, sepse e kemi në dallim prej 3 milion euro në mes punëve që janë kryer dhe kontratave që janë nënshkruar në këtë aspekt. Këto janë kontrata në vlerë mbi 4 milion e 100 mijë euro llogariten si borxhe për kontratat që janë nënshkruar, kurse janë 930 mijë euro borxhe për punët që janë kryer. Këtu është një dallim shumë i madh dhe këtu dikush duhet të ketë përgjegjësi, se pse nuk janë kryer punët? Te Zyra e Prokurimit ka shumë shifra të cilat kanë shkuar deri në 10 mijë euro dhe aty mendojmë se ka shumë për të thënë, por këtu nuk ka hapësirë për t' i thënë gjitha, prandaj edhe pse kam edhe shumë për të thënë, më duhet ta ndërpres fjalën për t' i lënë hapësirë edhe kolegëve të tjerë. Ju faleminderit për durim!

Sokol Haziri- e falënderoj kryetarin për paraqitjen e raportit dhe e përgëzoj për angazhimet që i ka bërë, sepse ky është një raport gjithëpërfshirës për të cilin mund të themi se ka edhe të arritura në punën e ekzekutivit dhe në Komunë në përgjithësi. Mirëpo nuk mund të thuhet se e tëra është një e arritur e madhe sa që nuk ka se çka të punohet më tepër.

Definitivisht e kuptoj partinë që është në pushtet që të paraqesin shifra të cilat i konvenojnë të paraqesin, fakte që janë në favorin e tyre, por do të ishte mirë që nganjëherë edhe t' i paraqesin edhe të metat, të cilat disa i tha kryetari, por mendoj se nuk janë të mjaftueshme, prandaj do të duhej të mësohet kryetari dhe partia në pushtet që të paraqiten edhe vështirësitë të cilat paraqiten gjatë punës dhe ballafaqimet të cilat ndodhin gjatë vitit në këtë sferë.

Unë nuk e dëgjova asnjë fjalë se ka vështirësi në kuptimin përfitimit të grandeve nga Qeveria e cila dukuri ka qenë temë dhe debat të cilën vazhdimisht e kemi cekë edhe në Kuvend.

E dyta do të ishte mirë që kryetari në këtë rast të potencojë diçka që është mediale dhe të flitet diçka për atë konfliktin e interesit e cila ndoshta nuk do të ishte pjesë e raportit, por për hir të gjithë përfshirjes ka qenë mirë edhe ky pozicionim të qartësohet, për t' i ditë gjërat ne dhe qytetarët e Gjilanit.

Unë mendoj se ka shumë për t' u bërë, por unë e falënderoj kryetarin dhe pozitën për bashkëpunimin që e ka pasur me ne si opozitë, sepse kemi pasur një bashkëpunim korrekt dhe kjo është një shtytje që i ka ndihmuar zhvillimeve pozitive dhe besoj se në këto zhvillime pozitive ka hise edhe opozita.

Sido që të jetë kryetari e tha një fjali se qytetarët e Gjilanit nuk kanë ra nëpër gropa, por kjo nuk do të thotë se nuk ka gropa të cilat nuk duhet të mbulohen dhe harrohen, por duhet të asfaltohen rrugët e reja për të pasur një zhvillim që është i dinjitetshëm për Komunën e Gjilanit. Unë nuk kam më tepër iu falënderoj për këtë raport!

Arben Maliqi-edhe unë në emër të grupit tim e përshëndes raportin njëvjeçar të kryetarit të Komunës i cili e elaboroi gjithçka që duhet. Mua ndoshta nuk më takon të jap kritika, sepse jam në koalicion me partinë në pushtet, por unë gjithmonë e kam thënë atë që është për të mirën e qytetarëve të Gjilanit.

Unë i kam edhe disa këshilla dhe po theksoj se në Komunën e Gjilanit ka ndodhur diçka shumë e dhimbshme e ajo është çështja e decentralizimit për të cilin rast nuk mund ta quajmë fajtor kryetarin e Komunës sepse është një proces që ka filluar shumë më herët. Me këtë proces ne kemi humbur shumë kilometra dhe qytetarët në vend të 6 km, udhëtojnë 30 km. Këtë nuk mund ta fshehim, kjo është një e metë e cila na ka ndodhur neve, por për këtë nuk kemi mundësi të bëjmë asgjë!

Tjetra është ajo që e përmendi më parë z. Haziri është investimet të cilat nuk kanë ndodhur në Komunën tonë. Këtë po e them haptas se edhe këtu nuk është fajtor kryetari, por është një faj i të gjithë njerëzve tanë të cilët i kemi në qendër. Kanë ndodhur shumë gjëra të mira dhe drejtoritë janë në nivelin e duhur dhe në tërësi e kanë kryer punën e vetë aq sa i takon, por ka disa drejtori të cilat po e them nuk udhëheqin vetë. Nuk udhëheqin vetë punën, sepse kanë disa njerëz anëve të cilët ia kryejnë punët, por nuk pajtohem me atë se ka gropa në Gjilan dhe sinqerisht po e them se kurrë qyteti më i mirë nuk ka qenë. Unë gropa nuk kam parë në qytet edhe pse këto ditë ka pasur reshje të mëdha.

Do të them diçka edhe për Drejtorinë e Kulturës për të cilën drejtori i dëgjova disa kritika, por unë e kam thënë shumë herë dhe e them prapë se ajo është drejtori e fukarallëkut!

Në atë drejtori kurrfarë financa nuk kemi, por ka edhe shumë mbulesa, prandaj këtë drejtori duhet ta mbështesim, sepse është një drejtori e cila merret me fëmijët tanë dhe rininë tonë.

Është një drejtori e cila fëmijët tanë nuk i len rrugëve, por i orienton në sporte, kulturë dhe aktivitete të tjera. Unë e falënderoj edhe kryetarin e Komunës i cili e ka pasur një qasje më të mirë në bashkëpunim me drejtorin me rininë me sportistë tanë të cilëve ia ka mundësuar për t' i bërë disa përgatitje ashtu si i ka hije sportistëve.

Duhet të them edhe diçka për Drejtorinë e Arsimit e cila është një drejtori me shumë rëndësi, por është një drejtori me një mal të problemeve, të cilat probleme nuk janë të varura nga drejtori dhe as nga kryetari. Kemi nevojë në arsim ende të punojmë, të angazhohemi dhe shkollat t' i funksionalizojmë dhe t' i sigurojmë kabinete më të mëdha dhe kabinete me numër më të madh të kompjuterëve, t' i sigurojmë salla sportive dhe fusha ndihmëse për sezonin e verës. Ne duhet patjetër ta dimë se nuk duhet të ndërtojmë shkolla të mëdha pa salla të edukatës fizike. Unë po përmendi se te testi i maturës po ndodh një gjë shumë e mirë, sepse më nuk do të ketë test të maturës të cilin fakt e kam përmend më parë. Më në raport të kryetarit nuk do ta kemi testin e maturës i cili nuk ka pasur vlerë fare, por do ta kemi një test krejt ndryshe, pra do t' i kemi dy teste brenda testit të maturës. Kjo është një e arritur e madhe e Ministrisë së Arsimit. E përshëndes edhe njëherë punën e të gjithë neve, por përshëndes edhe opozitën e cila ka luajtur rol me rëndësi, sepse opozita e ka bërë punën e vet që sukseset të jenë të barabarta. Ne nuk mund të krenohemi vetëm koalicioni, sepse kemi pasur një bashkëpunim të përbashkët.

Jakup Bajrami- raportin e kemi marrë me kohë dhe analizuar dhe konsideroj se në këtë raport janë cekur të gjitha të arriturat në Komunë me një sukses të përkryer ashtu si është thënë, me disa vërejtje në fund. Mirëpo konsideroj se ka edhe disa të meta të cilat nuk janë identifikuar e të cilat ka qenë desh të përmenden në mënyrë më kronologjike.

Në përgjithësi edhe unë po i jap dy-tri vërejtje të ia të cilat i kam vërejt gjatës kohës që kemi punuar.

Si vërejtje e parë është te punësimi në arsim, sepse gjyqi i ka kthyer disa punëtorë në punë të cilëve iu ka bërë e pa drejtë gjatë vlerësimit. Ka raste kur punësimet janë bërë në mënyrë politike, mandej ka punëtorë me kontratë në vepër dhe pa konkurs e për të cilin rast mendoj se edhe ajo është një ngarkim i buxhetit.

Mandej i kemi disa investime të cilat ndoshta janë bërë me qëllime më të mira, por nuk e kanë arsyetuar investimin e bërë. Sa për t' iu bindur unë po e përmendni shenjëzimin e rrugëve për të cilin rast janë disa investime mjaft mëdha dhe sikur ato rrugë të asfaltoheshin sërish, nuk do ta kishin vlerën më të madhe. Mandej janë bërë disa meremetime dhe asfalti i cili është shtruar më i fundit, ai së bashku me borën është shkatërruar. Këso raste ka në të gjitha drejtimet si në drejtim të Prishtinës, ashtu edhe në atë Bujanocit,

prandaj ka vend për të dhënë vërejtje, por vërejtjet do të shihen atëherë kur ta marrim raportin përfundimtar financiar me të cilin do të shihet se si i kemi shpenzuar mjetet dhe sa kemi obligime ?

Unë pajtohem me atë se është një klimë e mirë e bashkëpunimit dhe kjo është ajo që i jep një kahe pozitive Komunës dhe jemi për atë që të jemi shembull për komunitat e tjera ashtu siç po thuhet.

Elisah Ymeri- unë në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së e falënderoj kryetarin e Komunës për një raport të thukët prej 140 faqeve në të cilin raport janë të përfshira të gjitha të arriturat e Komunës në mënyrë detale. Këto të arritura na dallojnë nga komunitat e tjera dhe ne e inkurajojmë dhe e mbështesim kryetarin e Komunës për punën të cilën është duke e bërë, për qasjen e tij në raport me problemet, por e falënderojmë edhe për krijimin e klimës shumë të mirë edhe në raport me opozitën, por e falënderojmë edhe opozitën për ndihmën që na e ka bërë gjatë gjithë kohës. Ne e mbështesim këtë raport dhe e falënderojmë kryetarin për punën të cilën është duke e bërë.

Rashit Sahiti- e dëgjova me vëmendje raportin e kryetarit të Komunës dhe posaçërisht, raportin e Drejtorisë së Arsimit. Mirëpo në fillim po e përfilli fjalën e kolegut Arben Maliqi i cili punon në procesin edukativo-arsim i cili pos që i edukon gjeneratat e reja deshi të na edukojë edhe neve, prandaj faleminderit për atë, prandaj po i përshëndes kryetarin e Komunës, kryesuesin dhe të gjithë të tjerët.

Unë mendoj se fusha e arsimit pos atyre që i tha kryetari ka edhe fusha të tjera problematike të cilat nuk janë theksuar në raport. Edukimi para fillor, fillor dhe i mesëm i ulët dhe i lartë ka disa fusha problemore siç janë mungesa e terreneve sportive, mungesa e lokaleve për fëmijë parashkollor, mungesa e kabineteve dhe laboratorëve. Një numër i arsimtarëve ende nuk është aftësuar për zbatim të metodologjive të reja, shkalla jo kënaqshme e arritshmërisë së suksesit në tri nivelet e arsimit, mungesa e kabineteve dhe mosfunksionimi i punës teorike dhe praktike. Mandej buxheti financiar shumë i kufizuar i cili nuk garanton minimumin e kërkesave, burokracia e tepërt në infrastrukturën ligjore, mungesa për t' u përball me nxënës që kanë ngecje në arsim dhe edukim, mungesa e bashkëpunimit me prindër (trekëndëshi pedagogjik). Përgjegjësia e pronës shkollore si të mësimdhënësit dhe nxënësit, komuniteti ka krijuar gjendje të pa përballueshme nëpër shkolla për shkak të vetëdijesimit të ulët të një pjese të shoqërisë. Edhe sot mësimdhënësia vazhdon vetëm me metodën tradicionale edhe pse shoqëria investon në mësimdhënës për trajnime dhe seminare të ndryshme. Unë konsideroj se shumë nxënës janë para mësimdhënësve, ju faleminderit.

Zijadin Maliqi- unë e kam lexuar dhe raportin e kryetarit dhe drejtorive dhe jam përpjekur për t' i bërë disa krahasime në mes tyre. Së pari te raporti i kryetarit kam vërejt se vetëm te Drejtoria e Urbanizmit, kryetari i ka paraqitur sista të meta, kurse te drejtoritë e tjera çdo gjë është në rregull. Unë uroj që të jetë kështu, por këtu u paraqiten disa vërejtje, por këto ka qenë desh të paraqiten edhe në raport.

Unë do të ndalem vetëm në dy-tri drejtori dhe zyre të cilat janë pranë kryetarit, por për zyrat nuk ka asnjë fjalë në raport, por as Zyra për Personel nuk ka dhënë ndonjë raport.

Po filloj nga Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Ekonomi dhe te të dy drejtoritë, unë personalisht i kam disa paqartësi? Në raportin e kryetarit thuhet në një vend se të hyrat vetanake të planifikuara janë mbi 3 milion e 255 mijë euro, realizmi është mbi 3 milion e 524 mijë euro, apo janë realizuar më tepër 8.27%.

Më një vend më poshtë thuhet; Planifikimi i të hyrave vetanake është 2. milion e 750 mijë euro, kurse realizmi është mbi 3 milion e 131 mijë euro, nuk e kam të qartë si ka dalë kështu?

Te shpenzimet në bazë të raportit, por sot kryetari tha shifra tjera, kurse raportin që ne e kemi nuk ka përputhshmëri mes raportit të kryetarit dhe drejtorive.

Sipas raportit të kryetarit shpenzimet totale janë mbi 16 milion e 228 mijë euro, sipas drejtorisë janë mbi 19 milion 247 mijë euro (ato i përmirësoi kryetari sot dhe i tha), por edhe sipas kategorive ndryshojnë edhe drejtoria paraqet që është raporti janar-nëntor 2011.

Këto janë disa paqartësi për të cilat nuk do të ndalem më tepër, sepse në fund të këtij muaji do të paraqitet edhe raporti financiar ku do të kemi shënime edhe më të sakta.

Por ajo çka është për të theksuar është se te raporti i drejtorisë shpenzimet kapitale janë mbi 5 milion 390 mijë euro, kurse më poshtë thuhet se për investime kapitale të paguara janë mbi 2 milion e 417 mijë euro. Nuk e kam të qartë se pse është ky dallim?

Për Zyrën e Prokurimit në raportin që e ka dhënë kryetari është shumë i shkurt dhe paraqiten vetëm prokurimet sipas llojit, sa për punë, sa për furnizime etj. Nuk kemi në raport të Zyrës së Prokurimit as kryetarit sa ankesa kanë qenë nga operatorët ekonomik në OSHP dhe si janë vendosë ato? Nuk ka të dhëna se cilat janë sfidat e kësaj zyre, sepse ne e dimë se shumë prokurime shpallen edhe nga 4-5 herë. Në raportin e Zyrës së Prokurimit i kam vërejt disa shkelje të cilat i kam paraqit edhe vitin e kaluar edhe më herët me qëllim që ato të përmirësohen, sepse shumë aktivitete të Prokurimit ndahen me qëllim të ikjes së procedurave të prokurimit. Kjo mënyrë e prokurimeve e bënë që të shpallen me ftesën për kuotim, por dihet pse bëhen me ftesë për kuotim, sepse është më e lehtë dhe ndahen me qëllim që të realizohen ashtu edhe si janë. Kam parë atje se disa prokurime me ftesë për kuotim shkojnë edhe deri në 9 mijë e 990 euro dhe përfituesi është me këtë shumë, por ku janë edhe dy operatorë ekonomik të përgjegjshëm nën 10 mijë euro?

Më kanë ra në sy edhe disa shpenzime mjaft të larta e posaçërisht po e përmendi Zyrën e Kryetarit, sepse e kam parë në disa pjesë dhe të gjitha investimet të cilat ishin bërë për Zyrën e Kryetarit e arrijnë shumën mbi 49 mijë euro.

Te Zyra e Projekteve është një raport mjaft i gjerë, por në fund ajo që më interesonte ishin kërkesat të cilat Zyra e Projekteve ia ka bërë ministrive të ndryshme (Qeverisë) dhe ajo vlerë ishte afër 16 milion 500 mijë euro nëpër ministri të ndryshme. Mirëpo kërkesat janë diçka tjetër, kurse menaxhmenti i Komunës ka pasur mundësi të arrijë me autoritetin e vetë të përfitojë nga këto kërkesa, por unë e kam parë se nuk ka përfituar asgjë!

Mandej janë disa projekte që janë bartur nga vitet e mëparshme, janë dy shkolla në Komunë të Gjilanit edhe projekti i Lumit Mirusha dhe ato mjete janë të bartura nga viti 2011 në 2012.

I vetmi projekt i madh në Komunë të Gjilanit i cili është pa kërkesë të Komunës është ndërtimi i një burgu të madh në Komunë të Gjilanit, investimi mbi 4 milion e 100 mijë euro.

Këto ishin vërejtjet e mia, ju faleminderit!

Ramiz Ramadani- unë do të mundohem të jem sa më racional dhe po filloj me Drejtorinë e Urbanizmit për të cilën drejtori raportin e kemi pasur në Komitetin për Planifikim Urban dhe të gjitha vërejtjet, por dhe ndonjë lëvdatë ia kemi përcjell drejtoreshës.

Ajo që sot dua ta them këtu, është e rëndësishme për ta thënë se askund në raport nuk përmendet ndërhyrja në Planin regullativ Fidanishtja, të cilën ndërhyrje drejtoresha fare nuk e ka përmendur ashtu sikur mos të kishte ndodh asgjë. Për këtë duhet një sqarim dhe e dyta është ajo rreth PPP-së, është thënë shumë pak, vetëm me një fjalë të vetme në raport. Konsideroj se kryetari dhe drejtoresha kanë për obligim të na japin një shpjegim të cilin e kemi kërkuar vazhdimisht për procedurën ligjore nga njësia për PPP-në. Një shpjegim të na vijë se ka mbështetje ligjore dhe nëse ka mbështetje të tillë ligjore, atëherë mbështetja do të jetë edhe nga ana e jonë.

Unë do të them diçka për sferën e bujqësisë për të cilën drejtori, kryetari thanë shumë fjalë të mëdha, por as unë nuk dua të minimizoj asgjë dhe e vlerësoj mundin dhe profesionalizmin e drejtorit dhe të gjithë kolegëve. Në këtë raport pasqyrohet jo vetëm puna e Drejtorisë së Bujqësisë, por dhe aktivitetet e ministrisë dhe të organizatave ndërkombëtare të cilat aktivitete nuk po më pengojnë. Mirëpo detyra e drejtorit ka qenë që ky raport të bazohet në punë të drejtorisë, mandej në aneks të sqarohet se me kë bashkëpunon si me donatorë, ministrinë, Komisionin Evropian dhe mos ta krijojmë një përshtypje jo reale në opinion. Nëse thuhet se 2 milion e 200 mijë euro janë dhënë në bujqësinë e Gjilanit, në fund të raportit të thuhet sfidë e mëtejme mbesin investime e huaja. Problemi është se 1.5 milion shkojnë për tre biznesmen të cilën gjë duhet ta dijë edhe opinioni se ata janë tre afaristë të cilët nga Komisioni Evropian i kanë marrë ato mjete. Një kolonë që duhet të hiqet është participimi i fermerëve dhe ky participim është 165 mijë euro, kurse investimet prej drejtorisë janë 145 mijë euro. Të jetë e qartë nuk fiton fermeri duke participuar, prandaj duhet një pasqyrë sa më reale të jetë në raport.

Unë do t' i përmendi së pari projektet dhe projekti i parë është foli plastike 10 mijë euro të cilin projekt gjithëherë do ta përkrahim, por e kërkoj një sqarim, pse mungon kontrata dhe ajo që është dukuri negative, lista e përfituesve po na përsëritet. Janë 10 mijë ekonomi familjare dhe po t' i trajtojmë 1 mijë ose 900 është punë e madhe, por të jetë një rend, nëse njëri e merr një subvencion le ta merr edhe tjetri një?

Te projekti i makinave mjelëse edhe këtu mungon kontrata?

Te serrat është një ndër projektet që e konsiderojmë si investim publik, mirëpo ajo që dua them, por pa emër përfituesi i vitit 2009, është përsëri përfitues më 2011. Ky është një investim i madh dhe konsideroj se te këto raste duhet të kemi kujdes maksimal.

Lidhur me projektin e drunjve dekorativ, unë e kam parë raportin, por në raport ne nuk e kemi asnjë specifikacion. Mandej në këtë projekt është një shumë prej 300 e 20 mijë eurove, por kontrata që është nënshkruar është 250 mijë euro, kurse përfundimi i punëve 25 mijë euro.

Për këtë kërkojmë të dhëna më të sakta?

Saranda Bllaca- sa i përket raportit të Kryetarit fillimisht një vërejtje për mënyrën se si na është sjell, prandaj herëve të tjera është mirë që të na sillen në word, sepse dikush e tha se janë 130 faqe, por ato nuk janë faqe, por sllajde dhe këtu gjithsej janë më pak se 20 faqe i tërë raporti i kryetarit.

Unë kam disa vërejtje për Drejtorinë e Arsimit dhe të Kulturës dhe për raportin e Drejtorisë së Arsimit ne kemi debatuar gjatë edhe në Komitetin e Arsimit i cili raport është sjell shumë gjerësisht. Unë i shprehi shqetësimet e mia lidhur me suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë të cilin shqetësim e përmendi edhe kryetari dhe mendoj se nga 7778 nxënës që vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë sipas raportit të drejtorisë 46% janë me nota të pamjaftueshme. Mendoj se ky sukses i gjysmë vjetorit të parë është i tillë si pasojë e një kriteri pak më të ashpër të mësimdhënësve në vlerësim të nxënësve, gjë që praktika ka treguar se ky sukses po ndryshon shumë. Disa gjëra që janë sjell në raport kanë qenë të panevojshme pasi që ne i kemi debatuar më herët në një raport të muajit shtator të vitit të kaluar.

Unë kujtoj se sot ka qenë desh të sillen një raport për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të cilin nuk e kemi nga Drejtoria e Arsimit, atë të cilin e kemi pasur në komitet. Nga kryetari u përmenden shumë shkurt mënyra e ndarjes së bursave dhe shpërblimeve për studentët të cilat të dhëna mungojnë në këtë raport? Lidhur me notën mesatare, raporti nuk ka qenë i saktë në disa shkolla sa i përket asaj se si është nxjerr nota mesatare! Përlllogaritja e notës mesatare nxirret sipas rregullave matematikore dhe jo sipas ligjit dhe si e përcakton Ministria e Arsimit.

Unë nuk kam për qëllim për ta denoncuar askënd, por të jetë vërejtje që herëve të tjera duhet të llogaritet mirë nota mesatare e nxënësve të një shkolle ose të shkollave në përgjithësi.

Lidhur me Drejtorinë e Kulturës, kam vërejtje te raporti financiar në faqen e fundit që është sjell, i cili është një raport shumë i thjeshtë dhe këtij raporti më së paku mund t' i themi raport financiar. Aty nuk figuron asnjë datë, nuk dihet se ky raport për çfarë intervale kohore është paraqitur, nuk është raport i përpiluar sipas rregullave të kontabilitetit, mandej ka gabime teknike dhe drejtshkrimore. Është një raport shumë i thjeshtë shumë i mangët në të cilin janë paraqitur vetëm shpenzimet e Drejtorisë së Kulturës. Ne nuk e dimë sa ka pasur të hyra, prej nga janë marrë ato të hyra, për çfarë destinacione kanë qenë të planifikuara dhe a ka pasur plan për shpenzime të atyre të hyrave? Të gjitha këto nuk janë paraqitur fare, prandaj përfundimisht e them se ky raport nuk është raport i plotë financiar dhe është shumë i pjesshëm.

Këtu nuk figurojnë fare shpenzimet e Flakës së Janarit të vitit të kaluar e që besoj se ka qenë desh të jenë dhe jo të këtij viti, sepse ato duhet të sillen më vonë.

Përfundimisht kjo që na e keni sjell në emër të raportit financiar më së paku mund t' i thuhet raport! Një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës a ekzistojnë specifikacionet e këtyre shpenzimeve që i keni paraqit në këtë raport? P.sh SHKA-të si i kanë shpenzuar këto mjete ?

Një pyetje pak me humor për z. Arben Maliqi i cili e tha se në Gjilan nuk ka gropa, pyetja e ime është se a po ec nëpër Gjilan me aeroplan apo me çka? Unë për shkak të atyre gropave veturën time ka dy ditë që e kam, te mjeshtri.

Shpresë Kurteshi- unë pak fjalë do t' i them për Drejtorinë e Kulturës, në të cilin raport thuaja në çdo sektorë janë paraqitur vetëm anët pozitive, të cilat nuk janë ashtu edhe siç po thuhet se në raport. Nëse e marrim dhe e shqyrtojmë punën e Teatrit në Komunën tonë mund të themi se është i vetmi sektor i cili punon në kushte jo të mira, por përsëri ka shumë përpjekje për ta bërë punën e mirë. Përveç anës financiare në raportin e këtij sektori kemi ankesa se punën e tyre po e pengojnë edhe aktivitetet e Komunës së Gjilanit nga profile të ndryshme. Ne e kemi aprovuar një rregullore të cilën e kanë projektuar zyrtarët e Teatrit që t' i iu lehtësohet puna, por siç duket ajo rregullore ekziston vetëm në letër, sepse sipas tyre nuk duket se është e qartë puna, ata sërish kanë probleme me Komunën dhe organizata të tjera. Nuk është faji i njëanshëm, por edhe Drejtoria e Teatrit duhet ta respektojë dhe punojë duke e pasur parasysh rregulloren që e kanë.

E dyta çështje e cila ende mbetet e pazgjidhur për Teatrin dhe është mjaft problematike është nxënia e një hapësire mjaft të madhe Galerisë së Arteve e cila edhe sot funksionin si kafiteri në ballë të Teatrit. Drejtoria dhe Komuna në fakt kanë dështuar në këtë çështje pasi që nuk kanë bërë asgjë për t' ia kthyer Teatrit pjesën e vet, sepse Teatri mjaft po hendikepohet.

Ne kërkojmë që kjo kafiteri të hiqet prej ballit të Teatrit, sepse këtë hapësirë Teatri mund ta shfrytëzojë për interesa të tij. Ne me sa e dimë ka qenë një vendim i tillë për t' u larguar ajo kafiteri, por ende nuk është zgjidhur ky problem.

Sa i përket Bibliotekës, nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar, puna vazhdon në kushte të njëjta dhe përballet me hapësirën e pamjaftueshme për lexuesit e shumtë.

Sektori i Rinisë po e sheh qytetin vetëm me ngjyra të bukura, por askush nuk është kundër aktiviteteve humanitare, ekspozitave, argëtimeve, por nuk kemi parë se është organizuar ndonjë fushatë për vetëdijesimin e të rinjve për t' u larguar nga dukuritë negative si është droga alkooli, dhuna në familje etj.

Sa i përket sportit në Gjilan ekziston vetëm një Stadium i futbollit i cili është i rinovuar, kurse përkrahje i epet vetëm klubeve të futbollit vetëm në mënyrë simbolike, kurse sportet tjera janë të lëna anash.

Raporti i Flakës së Janarit 2011 ka qenë më herë në Kuvend, për të cilin raport i kemi dhënë vërejtjet me kohë. Mirëpo raporti i Flakës për vitin 2012 nuk ka kaluar në Komitetin e Kulturës. Projekti i Flakës i prezantuar për herë të parë në komitet është kthyer në rishqyrtim për shkak të kostos së lartë të paraparë në shumë prej 63 mijë 900 euro dhe për shkak të mos detajimit të projektit. Ne në mënyrë unanime kemi votuar që të kthehet për rishqyrtim i cili më nuk është sjell më në komitet.

Ne kemi vlerësuar dhe kemi marrë qëndrim që projekti mos ta kalojë shifrën mbi 45 mijë euro, kurse vërejtjet dhe sugjerimet e tjera i kemi dhënë në komitet. Mirëpo edhe ky raport në këtë formë edhe më tej është i pa detajuar. Si shembull është Bordi i Flakës e ka numrin 10, por kush janë këta 10 anëtarë? Për hir të transparencës këta emra duhet të bëhen të njohur, mandej grupet punuese duhet të dihet, sa gupe të tilla janë dhe kush janë ata njerëz që i përbëjnë këto grupe? Për përgatitje dhe disa gjëra nuk mund të thuhet se është ndonjë shumë më e madhe, por për akomodim, dreka dhe darka ka pasur mundësi që të jetë një shumë më e vogël.

Shifra prej 52115.00, ka pasur mundësi të reduktohet, por as kalendari i aktiviteteve nuk është prezantuar dhe pa kaluar në komitet është sjell në Kuvend.

Po të ishin mbajtur mbledhjet e komiteti, do ta kisha pasur një pyetje për drejtorin se si hyri 14 Shkurti si ngjarje kulturore në kalendar dhe me çfarë arsytimi?

Në fund ka vërejtje për drejtorinë se nuk ka bashkëpunim të mirëfilltë me komitetin dhe anëtarët e tij, sepse fare pak takime janë mbajtur dhe pak jemi informuar se çka po bëhet për kulturën dhe rininë në Gjilan. Gjithashtu duhet të keni kujdes për formën e shkrimit që e bënë në këto raporte dhe raportet e tilla t' i ngjajnë raporteve zyrtare?

Jhonë Hyseni- unë së pari po them diçka lidhur me nënshkrimin e kontratave publike, në të cilin raport shihet qartë një anashkalim i investimeve në shatin Zhegër dhe fshatrat për rreth. Në raport shihet se është nënshkruar vetëm kontrata për rregullimin e rrethojave metalike në Shkollën Fillore "Agim Ramadani". Ky projekt ka filluar, por është ndërprerë, prandaj pyes pse është ndërprerë dhe kur pritet të fillojë puna?

Po ashtu kërkoj që ta di se kur do të fillojë edhe rregullimi i infrastrukturës për nevojat e kësaj shkolle dhe shpimi e pusit për nevoja të kësaj shkolle?

Gjithashtu është edhe një investim tjetër si është ai për rregullim të rrugëve lidhëse në fshatin Lladovë, por kam një pyetje se për cilat rrugë është fjala?

E kemi të qartë se janë disa rrugë të paasfaltuara për të cilat në vitin 2009, kur ka filluar asfaltimi i rrugëve në këtë fshat janë anashkaluar, por nuk e dimë arsyen pse?

Gjatë vitit 2011 këto rrugë janë shtruar me zhavorr dhe deri më sot janë të paasfaltuara.

Për këtë kam një pyetje në emër të banorëve të këtyre lagjeve se kur do të përfundojë asfaltimi i këtyre rrugëve? I njëjti problem është me rrugën që lidh Zhegrën me fshatin Llashticë, sepse edhe kjo rrugë nuk ka përfunduar që nga viti 2009.

Gjithashtu i papërfunduar ka mbetur edhe projekti i ujësjellësit dhe infrastruktura e ujërave të zeza, por nuk përmendet fare as asfaltimi i rrugës kryesore, Zhegër- Gjilan, sepse më parë u fol se gjëja nuk ka gropa në Gjilan, por nëse dikush dëshiron të shoh gropa të mëdha dhe mezi të kalueshme të vijë deri në Zhegër!

Gjithashtu nuk përmendet as asfaltimi i rrugës në fshatin Nasalë i cili është një projekt i përbashkët me Komunën e Vitisë.

Zhegra është një komunitet i madh në Komunë të Gjilanit në rrugët e të cilit fshat është shumë i nevojshëm rregullimi i trotuareve, sepse si pasojë e mungesës së këtyre trotuareve viteve të fundit ka pasur shumë aksidente, por edhe me pasoja fatale.

Unë po i përkujtoj Zyrës së Projekteve dhe asaj të Kryetarit se së bashku me kërkesën për rregullimin e trotuareve janë bërë edhe disa kërkesa të tjera si është ajo për rregullimin e shtratit të një përrroske nga Stacioni i Policisë deri te lumi i fshatit, sepse me rastin e të reshurave ajo përrroskë del nga shtrati dhe bëhen vërshime në fshat.

Si kërkesë me rëndësi është edhe ajo për meremetimin dhe funksionalizmin e Çerdhes së fëmijëve, sepse Zhegra është një fshat i madh dhe nuk e ka të zgjidhur këtë problem.

Te raporti i Flakës, tek arti pamor, arti skenik, arti muzikor duhet të figurojë se sa artistë kanë qenë në forume artistike, sa të shpërblyer ka pasur dhe cilët artistë dhe persona janë shpërblyer? Nuk figurojnë as mjetet për anëtarët e bordit dhe stafin teknik.

Kam edhe një pyetje se cilat ishin burimet financiare të Flakës 2012, a ka pasur donatorë dhe cilët kanë qenë ata?

Jasahr Jashari- unë do të ndalem më tepër në Sektorin e Shëndetësisë, sepse në këtë lëmi jam më profesionist. Komuna e Gjilanit, përkatësisht Qeveria Komunale i ka ndarë Sektorit të Shëndetësisë 2 milion e 100 mijë euro nga buxheti i përgjithshëm i Komunës e që është 17 milion e 667 mijë euro, ose 11.8% e buxhetit të Komunës.

Nga kjo shihet se Komuna e Gjilanit do të mundohet ta mbajë vetëm me 11% shëndetësinë primare e që është një shifër e ulët për të pasur një popullatë të shëndosh.

Unë do them diçka vetëm te Sektori për Ujë, për cilin rast kryetari tha se kjo zyrë e ka kryer punën në mënyrë përfikthe! Unë po iu përkujtoj vetëm vlerësimin zyrtar i po kësaj zyre i cili citon: “ në zonat rurale niveli komintanues i ujit të pijshëm që e konsumon popullata, arrin në nivelin deri në 70% nga aspekti bakteriologjik dhe me ndotje deri në 45% nga aspekti kimik”.

Unë preferoj që Zyra për Ujë të hartojë programin me kohë në edukimin, trajnimin dhe klorizimin e puseve jo vetëm në zonat rurale, por edhe në qytet, sepse këto të dhëna janë shumë shqetësuese dhe është tejet e dëmshme që ky ujë me këtë nivel të kontaminim të përdoret për pije e që për pasojë ka shfaqjen e sëmurjeve infektive, apo ndonjë epidemie.

Aktivitet zyrtarë të ushtruara gjatë vitit 2011 nga Zyra për Ujë, hulumtimi i rregullt të ujit të pijshëm në zonat rurale dhe objektet e ujit nga zyrtari i po kësaj zyre thuhet: “ në institucionet shkollore dhe ambulanca janë marrë 80 mostra hulumtimi, por fatkeqësisht nuk e dimë cili është rezultati i këtyre mostrave të hulumtimit”, por që në këtë raport të zyrtarit mungon. Marrja e mostrave me kërkesë të komuniteti të muhaxhirët e Uglarit,

janë marrë tri mostra, por edhe këtu mungon rezultati i këtyre mostrave të marra. Nuk dihet se për çfarë uji bëhet fjalë?

Edhe te Fabrika e Përpunimit të Ujit, te Penda e Përlepnicës dhe fabrikat tjera si në Velekicë dhe Burimi Banja janë marrë 12 mostra, por as këtu nuk kemi rezultat të ujit të pijshëm edhe pse kemi kërkuar disa herë që të na epet përgjigje.

Zyra për Mirëqenie Sociale për vitin 2011 kanë qenë 5 familje të cilat i kemi cek edhe më herët të cilat i kanë përfituar nga 100 euro në muaj në bazë të projektit, por fatkeqësisht këto familje vetëm në periudhën janar-prill e kanë gëzuar këtë të drejtë!

Po ashtu edhe shpenzimet për vitin 2011 për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës kanë qenë 20 familje që kanë pasur një shumë mujore prej 130 euro, por fatkeqësisht edhe këto obligime ndaj këtyre familjeve janë kryer vetëm në periudhën janar-korrik, për gjashtë muaj këto familje kanë marrë vetëm premtime, por jo edhe kompensimin e premtuar. Me këtë dua të them se nuk ka pasur një plan të hartuar mirë për njerëzit në nevojë e që kemi mbetur në gjysmë të rrugës. Unë preferoj që këtë vit të bëhet ndarja e subvencioneve në mënyrë proporcionale dhe mos të dalim komik para qytetarëve.

Zyra për Shërbime Shëndetësore, aktiviteti i së cilës zyre ka qenë për pranim të kërkesave të palëve, skema për barëra dhe mjete të tjera terapeutike.

Në këtë Zyrë janë pranuar si kërkesa të palëve, lëndë pranimi 531, lëndë të aprovuara 240, të refuzuara 281. Me keqardhje po e them se vlera e dedikuar për ndihmë qytetarëve në ndihmë për barëra ka qenë 18 mijë e 220 euro e që as përafërsisht nuk kemi pasur mundësi t'iu ofrojmë një ndihmë klientëve tanë dhe ajo ka qenë një ndihmë simbolike.

Unë uroj që këtë vit buxheti të jetë më i lartë në mënyrë që sado pak t'iu dalim në ndihmë kësaj kategorie të shoqërisë.

U përmenden edhe investime kapitale DSMSH dhe përshëndes ç'vëndosjen e Ndhimës shpejtë nga QKMF, në lagjen "Dardania", por kjo ç'vëndosje për mua nuk paraqet ndonjë investim kapital. I mbështes investime e tjera si rregullimin e oborrit në QKMF "Dardania", rregullin e kulmit në Pogragjë, rregullimin e kulmit në Zhegër, rregullimin e oborrit në "Arbëri", vëndosjen e kamerave në QKMF etj. Mirëpo mua më intereson se pse në raport nuk është theksuar kostoja për këto investime?

Dhe në fund objekti i banimit social në të cilin objekt janë vëndos 26 familje kurse investitor ka qenë Ministria e Mirëqenies Sociale, por në raport thuhet: "ne si drejtori nuk kemi qenë të kënaqur me aktivitetin e punëve që janë bërë, sepse janë konstatuar shumë parregullsi që në fillim".

Për këtë kam pyetje pse keni lejuar pranimin e objektit teknik në fjalë, kur ju e keni ditë se objekti ka shumë defekte? Cili ishte komisioni i cili e ka bërë pranimin e teknik të objektit?

A ka pasur mbikëqyrje objekti dhe a i ka dhënë përgjegjësi dikujt ky komision ?

Bahrie Veseli- unë do të përqendrohem dhe do ta jap kontributin tim dhe do të flas diçka vetëm për raportin e Drejtorisë së Arsimit. U tha edhe më herët se ky raport është bukur i mangët, sepse mungojnë komplet të dhënat për gjysmë vjetorin e parë të këtij viti shkollor.

Raportet e drejtorëve të shkollave nuk përpunohen me të dhënat që i kanë përpunuar Drejtoria e Arsimit! Mandej kam vërejtje se po bëhen shkelje ligjore të përditshme me rastin e pensionimit të shumë arsimtarëve nëpër shkolla, sepse nuk po shpallen konkurse për ato vende dhe pastaj po pranohen në mënyrë jo të rregullt mësimdhënësit e tjerë.

Për këtë arsye kërkoj që ta di se sa punëtorë janë në Drejtorinë e Arsimit me kontratë në vepër?

Mandej sa punëtorë janë pranuar me konkurs, kurse në planin e punës drejtori të na jep përgjigje se a i ka paraqitur objektivat dhe a keni mundur t'iu realizoni objektivat e juaja gjatë këtij viti? Nëse i keni realizuar na i thoni, nëse jo na i thoni cilat kanë qenë sfidat për mospërmbushje të objektiveve të juaja?

Nga z. kryetar u tha se çdo gjë është në rregull, si me disiplinë, me punë etj, por unë nuk pajtohem me mendimin e kryetarit ngase i dimë rastet për disiplinë në shkollë.

Për këtë po pyes a funksionon komisioni disiplinor në shkollë? A është ndëshkuar ndonjëherë ndonjë nxënës për numrin e madh të mungesave? Mandej nuk besoj se çdo gjë është në rregull në atë masë sa edhe asnjë

arsimtar nuk ka merituar ndonjë vërejtje! A ka funksionuar ky komision dhe a ka marrë ndonjë masë në këtë drejtim?

Gjithashtu vitin e kaluar me rastin e 7 Marsit janë zgjedhur arsimtarët më të mirë pa kritere të cilëve u desh t'iu epen shpërblime. Unë jam në dijeni se ata arsimtarë kurrë nuk i kanë marrë shpërblimet të cilët janë zgjedh vitin e kaluar.

Gjithashtu dëshiroj ta di se çfarë ka ndodhur me nxënësen Genta Latifaj e cila ka marrë pjesë në gara ndërkombëtare së cilës iu ka ndarë shpërblimi, por atë nuk e ka marrë asnjëherë.

Pse nuk e ka marrë shpërblimin?

Në fund po e them se nuk pajtohem me kryetarin i cili po thotë se rrugët janë të asfaltuara dhe pa gropa, por është rruga "Ali Hadri" e cila ka plotë gropa, është rruga që shkon në drejtim të varrezave, është ajo që shkon për Ferizaj dhe ajo për Malishevë të cilat kanë plotë gropa.

Në fund edhe një kërkesë të cilën e kemi bërë edhe me shkrim, sepse në Lagjen e Tetë e kemi një rrugë në të cilën me shumë vështirësi mund të kalojnë dy automjete dhe është rrezik për qytetarët.

Mandej më intereson ta di sa është numri i punëtorëve në SHCK, a ka numër të tepërt të punëtorëve në këtë shërbim?

Një mangësi tjetër është se askund nuk ekziston Zyra për Barazi Gjimore, sepse do të duhej edhe të ishte një raport nga kjo zyre. Është lëshim, apo nuk funksionon kjo zyre?

Abdyl Aliu- unë e vlerësoj punën e kryetarit dhe të të gjithë drejtorive për hartimin e këtyre raporteve ashtu si janë. Ajo që ka qenë desh të bëhet është se këto raporte ka qenë e nevojshme për të kaluar nëpër komitete përkatëse. Unë nuk e di pse nuk është bërë kjo?

Për raportin e Drejtorisë së Urbanizmit e di që ka kaluar nëpër komitet për të cilin rast e përgëzoj drejtorinë për këtë punë!

Raporti i kësaj drejtorie e ka vetëm një anë të medaljes, kurse anën tjetër është pa sens të duhur, sepse nuk ka vetëm punë të mira, por ka edhe shumë mangësi në këtë drejtori.

Ky raport ka gabime në drejtshkrim, nuk është gjithëpërfshirës, nuk është i qartë, bindës dhe është mjaft konfuz dhe nuk paraqet ngjarjet në mënyrë kronologjike.

Kam vërejtje edhe për dizajnin e tij, sepse është shkruar me shkronja të mëdha, vetëm për të dal sa më voluminoz dhe janë 17 faqe të cilat kanë pasur mundësi të përfshihen në 5-6 faqe.

Kur është fjala për banesat kolektive, duhet theksuar se numri i këtyre objekteve është shumë më i madh se sa ia tyre që janë paraqitur në raport nga drejtorja, në seancën e kaluar.

Me keqardhje unë konstatoj se është gjendje kaotike në këtë rrafsh. Ajo që po e theksoj është se këto ndërtime i kanë dal nga duart KK-së dhe më konkretisht akterëve të cilët do të duhej të merreshin me këtë punë. KK, kur janë në pyetje ndërtimet e tilla, mundin më të madh që e bën është që t' i arkëtojë të hollat në emër të rregullimit të taksës ndërtimore.

Por edhe një punë tjetër që e bën është që në fund të konstatojë që disa ndërtues kanë bërë tejkalim nga leja ndërtimore e cila iu është dhënë. Komuna në këtë rast merret me pasojat në vend që të merret me shkaqet që i sjellin këto pasoja.

Problem në vete sjell edhe mbikëqyrja e këtyre ndërtimeve nga aspekti i cilësisë së materialeve që përdoren në ndërtim.

Në raport përmenden zonat sizmike dhe dëshiroj që këtu t' i bashkohen dëshirës sime që të mos ndodh ndonjë tërmet në Komunën e Gjilanit i cili do t' i sprovonte këto objekte nga aspekti i statistikës. Nisur nga kjo unë i rekomandoj drejtorisë që t' i merr disa projekte dhe t' i krahasoj ato si shembull te statika dhe të jep përgjigje në disa pyetje: pse një ndërtues sipas llogarisë statike në themel përdor armaturë "f"- 20 mm, kurse për të njëjtin pozicion një ndërtues tjetër përdor armaturë "f" 16 ose 14?

A mund të merret me mend se çka do të thotë kjo nga aspekti i statistikës dhe qëndrueshmërisë? Shembuj të tillë ka shumë dhe përgjegjësi e madhe është për Komunën që nuk i ka përcjell këto ndërtime me kohë, nëse ndodh ndonjë fatkeqësi natyrore nga tërmetet.

Si aktivitet që figuron është edhe ajo për hartimin e planeve rregulluese i cili është aktivitet mjaft i rëndësishëm dhe këtu pajtohem se punohet me shumë vullnet dhe pa lodhje, por kur është fjala për këto plane, kam një pyetje se ku është roli Këshillit të Ekspertëve në këtë rrafsh? Këtë pyetje po e bëj, sepse Këshilli i Ekspertëve, drejtpërdrejtë do të duhej të merrej me këtë çështje? Unë e kam bindjen se ky Këshill është formuar vetëm sa për të qenë në letër, sepse është obligim i cili rrjedhe nga Ligji për planifikim hapësinor, por unë nuk e di që ky Këshill është duke funksionuar.

Pika e fundit është hartimi i strategjisë dhe pjesëmarrja nëpër seminare për gjendjen mjedisore, e cila fjali është e shkruar mirë dhe pa asnjë gabim në aspektin drejtshkrimor dhe pajtohem se janë hartuar strategji për mbrojtjen e mjedisit, janë organizuar seminare, janë bërë vizita studimore etj. Mirëpo shtrohet pyetja sa është e kënaqshme situata në aspektin e mbrojtjes së mjedisit në të tri komponentët, tokë, ujë dhe ajër? Ekspertët sigurisht se do të pajtoheshin me mua se kjo situatë është larg dhe shumë larg nga ajo që e dëshirojmë!

Drejtoria mund të shkruajë sa të dojë strategji, por unë vetëm një fakt po e them! Në lagjen time “Zabelin e Sahit Agës”, deri para pak kohe kanë qenë dy deponi ilegale të mbeturinave për të cilat kam alarmuar disa herë. Mirëpo pasi që janë hartuar këto strategji, tash në atë lagje time janë tri deponi ilegale! Kjo gjendje e rëndë fatkeqësisht mund të themi se është e njëjtë në tërë Komunën e Gjilanit, prandaj nuk mund të themi se ka progres në këtë drejtim dhe të shtiremi se gjëja është në rregull. Unë nuk jam duke bërë politikë, por kjo është e faktuar dhe këtë mendim e kanë edhe qytetarët të cilën nuk bëjnë politikë.

Gjithashtu është për keqardhje se nuk është asnjë fjali e vetme për Planin e punës së drejtorisë për vitin 2012, për mbrojtjen e mjedisit.

Do të ishte keq për këtë Komunë nëse nuk bëjnë ndonjë ndërhyrje në këtë Plan dhe të fusin në agjendë diçka më tepër në këtë drejtim. Ju faleminderit për durim!

Qemajl Mustafa- unë iu përshëndes dhe fillimisht po filloj me disa vërejtje që u dhanë nga shumë këshilltarë dhe si fillim u tha se në raport nuk janë theksuar të metat, por janë përmendur vetëm sukseset.

Kjo absolutisht nuk qëndron, sepse unë i theksova disa të meta të Urbanizmi, Inspeksioni, të Gjeodezia, i përmenda disa të meta në Arsim etj. Mirëpo këto nuk janë të meta të qeverisjes, por janë të meta për shkak të mungesës së mjeteve.

Është thënë nga Arbeni nuk ka pasur komunikim të duhur! Kjo nuk qëndron, sepse ka pasur vazhdimisht komunikim dhe vazhdimisht ka marrë përgjigje. Nëse dikush nuk të ka kthyer përgjigje të kam thënë në këtë sallë, atëherë drejtoje tek unë shkresën. Shërbimin Civil e keni të hapur që nga dera e kryetarit deri tek rojtari! Nuk do të ketë mundësi askush as opozitës as shoqërisë civile, t’i thotë:” jo nuk të jap informacion”! Dikush tha raporti nuk është i detajuar. Ju së pari u ankuat se raporti është i gjatë, por raporti i një kryetari të Komunës, një ministri është raport përmbledhës që përfshin makro-parametrat zhvillimor dhe i reflekton makro zhvillimet dhe makro suksesin dhe makro të metat, por jo detalet.

Për Njësinë e Auditimit dhe planin e punës të Zyra e Prokurimit janë kufizime ligjore të cilat duhet kuptuar njëherë e përgjithmonë, është kufizim ligjor, nuk publikohet plani i punës i Departamentit të Prokurimit për arsye të cilat i thotë ligjdhënësi.

Thuhet se kemi raste kur dikush është afër 40 herë në komisione për vlerësim! Mund të jetë edhe 400 herë nëse dikush është profesionist, por tash nuk paguhen këto komisione, dikur janë paguar. Në këtu e kemi numrin e kufizuar të profesionistëve, këtë e dini!

Mbikëqyrjen thuhet se e vazhdon Komuna. Kjo ndodh vetëm në ndonjë rast të veçantë dhe kur ka specifikë.

Sinjalizmi u tha se shlyhen shenjat në rrugë. Mua më është thënë se janë përdorur më të mirat materiale dhe ato materiale qëndrojnë 24 muaj, por unë nuk jam profesionistë i kësaj lëmie.

Procesi është i hapur urdhëroni shkoni atje janë paramasat, janë përshkrimet, është ajo që është blerë dhe kontraktuar etj.

U tha se bujqësia është në funksion të një grupimi politik. Unë po e them se çdo gjë është e hapur si proces, çdo gjë është bërë profesionalisht me dijen që ne e kemi, procedurat janë të hapura për publikun dhe ka konkurruar kush ka pasur dëshirë. Janë realizimet janë pagesat e tërë është proces i hapur.

Unë po e them vetëm një gjë që nëse ju më sillni fakte se drejtori im, cilido që të jetë sillet në mënyrë selektive ndaj publikut e diskriminon një grupim të caktuar për arsye të caktuara, po iu siguroj se do të marrë masa ma të rrepta ligjore të mundshme.

U tha diçka për “Flakën e Janarit”. Nuk ka transparencë më të madhe se ajo që po ndodh në raportet e këtij manifestimi. Përgjithësisht vitin e kaluar e keni kërkuar 5-6 herë këtë raport dhe iu a kemi sjell, tash e kemi dërguar me kohë dhe e keni. Unë përkushtim të veçantë kam pasur që të reduktohen ato shpenzime dhe Flaka mos të shkojë si ishte vitin e kaluar që ishte vit jubilar me 70 mijë euro, por të mbesin diku deri në 50 mijë dhe aty jemi.

Sa i përket detalizimeve kërkon, sepse edhe i vetmi një njeri nëse ekziston në projekt me emër dhe mbiemër kush ka marrë një shpërblim?

Te borxhet, dikush ka pas kërkuar me transparencë ashtu si e kemi përcaktim dhe po theksoj se të gjitha projektet rreth 4 milion janë projekte të filluara e të pa përmbyllura, kurse borxhi i mbetur është ky të cilin e thatë ju. Të tjerat 3 milion janë borxh për punë të kryera, kaq u kemi borxh punë kryesve. Pjesën tjetër nuk kemi borxh, kemi borxh kur t’ i përfundojnë projektet. Për t’ i përfunduar të gjitha ato projekte dhe për t’ i pranuar teknikisht na duhen edhe 3 milion të tjera. Unë këtë e kam thënë haptas, asgjë nuk kam fshehtë.

Investimet nga Qeveria janë të pakta u tha, por këtë e kam thënë se nuk janë të mjaftueshme.

Për konfliktin e mundshëm të interesit, unë thash të gjitha këto, por ai konflikt është eliminuar, sepse kurrë nuk ka ekzistuar. Ai ka qenë një konflikt i mundshëm dhe ai ka qenë në bazë të ligjit për parandalim të konfliktit të interesit.

U tha diçka lidhur me punësimin në arsim me kontrata të përkohshme, por në arsim ka vetëm zëvendësime me kontrata të përkohshme. Të gjitha punësimet e tjera janë me konkurs.

Së shpejti do ta merrni raportin e Auditorit të Jashtëm dhe në mënyrë të veçantë do ta shihni se do të kemi komplimente për mirëmbajtje të dosjeve si në arsim dhe në sektorë të tjerë.

Mandej nga Rashit Sahiti u thanë disa vërejtje për hapësirat shkollore, por nëse ndonjëherë është bërë investim për hapësirat shkollore janë këto katër vjet, por a janë të mjaftueshme nuk jua në, sepse ende ka shumë nevojë! Ne kemi ndërtuar salla deri në 300 mijë euro e dyta është përfundim e sipër, mandej kemi rregulluar terrene sportive, kemi rinovuar salla etj.

Shtrohet pyetje a janë mjaft? Nuk janë mjaft! Kemi numër të madh të nxënësve.

Relacioni me prindërit funksionon për mrekulli, unë kam informacione se Këshilli i prindërve dhe i nxënësve funksionojnë për mrekulli dhe drejtorja është në kontakt të përhershëm me prindër dhe nxënës.

Te pjesa financiare është një paqartësi të cilën Zijadini e tha me plotë të drejtë, sepse 2 milion 750 euro nëse ka mbetur ndonjë shënim, ajo ka mbetur nga raporti 11 mujor i cili ka qenë me atë debatin me qytetarë dhe atëherë ka qenë ajo periudha 11 mujore.

Prandaj 3 milion e 750 mijë euro ka qenë planifikimi i të hyrave, sepse për çdo muaj është 250 mijë euro. Ndërsa ajo 3 milion e 255 mijë euro është një gabim i tyre (ministrisë).

Te ftesa për kuotim i kemi afër 70 ftesa të tilla, por nëse qëndron kjo 9990 dhe janë edhe dy të tjera me nga 9992 edhe për mua nuk është në rregull dhe ju siguroj se pajtohem me ju.

Mirëpo ajo çka garantoj është se asnjëherë nuk ndodh që të bëhen ftesa për kuotim për hatër të një punë kryesi.

Tenderët shpallen disa herë nëse diçka ligjërish nuk është në rregull.

U përmenden shpenzimet te Zyra e kryetarit, por nëse është fjala për një renovim i cili renovim tek unë ka ndodhur në dy faza dhe me sa unë mbaj në mend një fazë është afër 15 mijë euro, kurse pjesa tjetër 7-8 mijë euro dhe e tërë ajo ndoshta mund të jetë 25 mijë euro.

Nuk qëndron ajo që thuhet 45 mijë euro, ajo zyrë nuk është e Qemajl Mustafës, por është e kryetarit.

Fidanishtja është temë e tejkaluar, me atë pjesë çka keni desh keni bërë me te. Keni thënë nuk bën pa procedurë e kemi sjell në Kuvend dhe i keni ngrit gishtat për të hyrë në procedurë.

E kemi respektuar procedurën me ligj, e kemi mbyll procedurën me ligj dhe prapë keni kërkuar për ta rikthyer ju opozita e kemi rikthyer kemi debatuar e kemi rivotuar dhe rimbyll.

Unë nuk e kam që qartë çka të bëjmë më tepër?

PPP edhe kjo monotone e keni komitetin dhe ky Kuvend ia ka dhënë mandatin Komitetit për Politikë dhe Financa me kërkesën e juaj që të merret me këtë çështje. Ai komitet për ditë po merret me këtë çështje.

Lidhur me bujqësinë po them asnjë punë nuk do të ishte bërë për pa qenë koordinator Drejtoria e Bujqësisë. As donatorët nuk do të mund ta kryenin punën e vet po të mos ishte drejtori dhe drejtorja. As Qeveria nuk mund ta kryejë punën dhe këtë e di shumë mirë Ramizi.

Investim është edhe bashkëfinancimi, pa qenë Drejtoria e Bujqësisë me fermerë për të filluar një projekt ajo nuk ndodh. U tha se 2 milion e 600 mijë janë shumë mjete! Më vjen keq nga Ramizi dhe mendoj se as që ke menduar kështu, por e ka bërë ndonjë lapsus! Këto mjete prej 2 milion e 600 mijë euro investim për bujqësi në një komunë janë rrafsh si 2600 euro në një ekonomi familjare. Çka mund të bëjë një familje me ato 2600 euro? Aq mund të bëjë ekonomia e bujqësisë në Gjilan. Me 22 milion euro do të duhej për ta zhvilluar bujqësinë!

Për drunjtë dekorativ procesi është i hapur, mund të informoheni kur të doni!

Nota mesatare u përmend, por ajo edhe sot llogaritet gabim, këtë po ia them haptas Sarandës.

Raporti financiar i DKRS-së, nuk ka qenë qëllimi që të raportohet financiarisht sot, sepse raportin financiar e keni në seancën e ardhshme.

Çështja e kafiterisë është e vërtetë dhe qëndron që është e okupuar, por ne jemi duke u marrë me këtë rast.

U tha nga dikush se biblioteka po punon në kushte të vështira, kjo është sa për të thënë diçka.

Ky këshilltar nuk ka asnjë informacion se ka filluar investimi prej 2 milion për ndërtim të bibliotekës së re.

Sporti vetëm një stadium. Mungesë totale e informacionit, sepse stadiumi tjetër është i kontraktuar.

Ndotja e ujit unë nuk e thash se është për mrekulli, unë nuk e thash për mrekulli e thash ka punuar mirë dhe është angazhuar mirë dhe kam thënë se problem të veçantë paraqet uji në zonat rurale edhe edukimi jo i mjaftueshëm në ato zona. Edukimi shëndetësor jo i mjaftueshëm.

Objekti për banim social, ne nuk kemi desh ta pranojmë në atë formë, por nga ana e ministrisë nuk ka pasur mjete dhe po të mos ishte pranuar teknikisht ato familje ende nuk do të ishin strehuar aty. Ne e kemi marrë për sipër për t' i financuar ato finesa për mos i lënë ato familje jashtë. Ne i kemi evituar ato të meta dhe familjet i kemi vendos në atë objekt.

Ne nuk kemi qenë të kënaqur me kualitetin e punës që është bërë atje, por atë e ka bërë Ministria për Mirëqenie Sociale.

U përmend disiplina në arsim. Unë e kam thënë se nuk ka fërkime në arsim e që i njeh publiku, por është e pamundur të mos ketë konflikte të vogla të fëmijëve të asaj natyre me 26 fëmijë brenda ditës në shkollë. Unë kur e kam thënë se nuk ka probleme në shkollë e kam thënë në atë kuptim që ka pasur më parë si rrahje, therje, sakatosje etj.

U përmenden gropat në qytet, por unë po i them se shumë do të mundoheni dhe nuk do të mund të gjeni gropa, sepse përkushtimi i im dhe i Drejtorisë së Shërbimeve Publike është 24 orë. Unë për ta heq borën kam qenë në lidhje 24 orë me kompanitë dhe me të gjithë zyrtarët që merren me këtë problematikë.

U bë pyetje a ka tejkalim të punëtorëve në SHCK? Nuk ka tejkalim dhe po iu them me përgjegjësi të plotë se 32 janë me kontrata afatshkurtra dhe të gjithë janë njerëz që bëjnë punë të vlefshme dhe po të vinte dikush tjetër në qeverisje iu siguroj se pa ata njerëz nuk do të kenë mundësi të punojnë. Nuk do të mund të punojnë pa pylltarë shtesë, pa inspektorë shtesë dhe pa zjarrfikës shtesë e që janë 11 etj.

U tha gjendja kaotike të ndërtimit. Kjo aspak nuk qëndron, ky është vlerësim paushallë, nëse dikush e ka mbajtur prej vitit 2000 e këndeje gjendjen në rregull e ka mbajtur Qemajl Mustafa, Urbanizmi dhe Inspeksioni në këto 4 vjet. Për këtë jam shumë krenar dhe ballafaqohem me kë të dëshironi. Për këtë unë kam insistuar që të futet ajo taksa prej 200% për të pasur mundësi për ta mbikëqyrë dike prej kur ta hap gropën dhe vazhdimisht për t' ia mbikëqyrë punën deri në kulm. Këshillin e ekspertëve e keni propozuar edhe ju edhe ne, por tash edhe unë jam i mendimit që ta biem në Kuvend dhe ta bëjmë një rifreskim dhe secili subjekt të sjellin emra që mund të japin kontribut.

Unë po them se mirë kemi punuar shumë këto katër vite, prandaj mos ta banalizojmë, mos ta prishim hijeshinë, ju keni të drejtë për qenë kritik, por argumentues.

Ju faleminderit për durim dhe kërkoj falje nëse më ka mbetur ndonjë pyetje apo vërejtje për pa i dhënë përgjigje. Ju faleminderit !

Pas kryetari e përfundoi elaborimin e tij dhe dha përgjigje në vërejtje dhe sugjerime të anëtarëve të Kuvendit, kryesuesi i KK-së. z. Zeka propozoi që të aprovohet ky raport.

Aprovohet raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2011 me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër, abstenime nuk pati.

Izmi Zeka: ashtu si u morëm vesh në fillim të seancës tash i kemi në radhë edhe katër pika të cilat duhet të aprovohen në Kuvend, për shkak të nevojave urgjente të cilat janë paraqitur e të cilat pika janë:

3. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2010, në vitin fiskal 2012
4. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2011, në vitin fiskal 2012-
5. Propozim-vendimi për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizmit të të hyrave të planifikuara nga viti 2011 dhe bartja e tyre në vitin fiskal 2012
6. Propozim- vendimi për lejimin e transferimit të mjeteve financiare

Qemajl Mustafa- këto katër pika me automatizëm duhet të aprovohen në Kuvend dhe për pikën e parë janë mbi 26 mijë euro të cilat i keni në vendim të sqaruara të cilat janë bartë në vitin 2011, por nuk janë shpenzuar dhe barten, sespe janë të hyra vetanake, ato nuk shkojnë në suficit. Këto mjete janë propozuar se ku duhet të shpenzohen e keni në vendim.

Te propozimi i katërt janë 269 mijë euro, por kur të mblidhet kjo shumë me atë 3 milion e 255 mijë euro, bëjnë 3 milion e 524 mijë euro sa është i tërë inkasimi. Këto janë mjete të cilat nuk janë trajtuar, kurse tash ministria i ka lejuar për t' i përdor. Ministria këto mjete i ka lejuar më vonë për shkak të bilanceve në nivel të Kosovës, por tash ka dhënë sinjale se mund t' i shpenzojmë, prandaj i kemi sjell në këtë seancë që të mos vonohemi.

Propozimi i pestë është i njëjtë, do të thotë 269 mijë euro, kurse tash vetëm duhet miratim, sepse duhet njëherë Qeveria ta miratoi tejkalimin që e kemi inkasuar më shumë, pastaj të kthehen për t' i shpenzuar.

Propozimi i gjashtë është shpërndarja e këtyre mjeteve nëpër kode buxhetore

Zijadin Maliqi- unë mendoj se sa i përket vendimit të parë dhe të dytë nuk ka asnjë problem, sepse ato barten, janë mjete që kanë mbetur nga viti 2010 dhe ato duhen të transferohen në 2012, por edhe të 2011 në atë të 2012, mjetet nuk mund të shpenzohen sidomos në muajt e fundit.

Unë mendoj se propozimi i tretë dhe katërtë nuk kanë problem, ato mjete mund të transferohen, por paraprakisht u desh të dihet se ky tejkalim i mjeteve, se në cilën kategori kemi tejkalime? Është e ditur e din edhe drejtori se disa mjete nga disa kategori nuk mund të barten për mallra dhe shërbime edhe me siguri aty ka mjete të tilla.

Për tjetrën ne njëherë e kemi bërë një transfer dhe më duket se ky Kuvend edhe atëherë ka qenë në gabim, sepse e kam thënë se ende pa u grumbulluar këto mjete, ne e kemi bërë transferin.

Unë kam dhënë vërejtje se te mallrat dhe shërbimet kemi mjete shumë, por tash po del se prapë edhe 270 mijë euro barten në këtë kategori!

Vendimi i fundit për mua është i pakuptimit, sepse ende pa filluar viti fiskal ne po i shkurtojmë projektet dhe po i transferojmë te mallrat dhe shërbimet.

Qemajl Mustafa- së pari mjetet e bartura, barten me qëndrim të MEF-it, aty ku dëshiron Komuna. Ky është qëndrim. Tjetra qëndrim i MEF-it dhe FMN-së është që mjetet nga inkasimi vetanak të destinohen rrafsh ku dëshiron Komuna e cila gjë nuk ka ndodhur deri më tash.

Mandej Zijadini e tha se ka mallra dhe shërbime shumë, por ka bërë gabim edhe ka bërë gabim të madh! Ju e dini se ne kemi hapësirë shkollore të re, rrugët e reja, ndriçimin publik të ri dhe të gjitha këtë duan shpenzime, të gjitha duan mallra dhe shërbime.

Është bërë shkolla e re, por nuk e ka planifikuar personelin e ri, nuk e ka planifikuar rojën, pastruesin, mirëmbajtësin, por edhe personelin etj. Për këtë na duhen mallra dhe shërbime, absolutisht nuk qëndron kjo se i kemi shkurtuar 15% projektet nuk dëmton asgjë.

I kemi nxjerr 388 mijë euro, kurse duhen te mallrat dhe shërbimet 480 mijë euro, për t' i alokuar te arsimit, sepse aty përfshihen sigurimi fizik, mirëmbajtja të cilat i kemi dërguar në kompani private.

Unë kam besim te të gjithë ju, sepse këto mjete po shkojnë në shërbim të Komunës dhe jo të kryetarit të Komunës ose një individi të caktuar.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi, propozon që këto katër propozime të aprovohen në paket?

Aprovohen në paket këto katër propozime:

3. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2010, në vitin fiskal 2012

4. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2011, në vitin fiskal 2012-

5. Propozim-vendimi për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizmit të hyrave të planifikuara nga viti 2011 dhe bartja e tyre në vitin fiskal 2012

6. Propozim- vendimi për lejimin e transferimit të mjeteve financiare

me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër.

Me këto pika të rendit të punës, seanca i përfundoi punimet në ora 16

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi Zeka